



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:144553

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05436387

KF.nr.335/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit Matkos Pharm Sh.P.K. me numër unik identifikues 811159624 dhe seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson S.K. avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, lidhur me anulimin e vendimit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me 13.02.2024 në prani të përfaqësuesit të autorizuarit të palës paditëse S.K. dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur M.K., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Matkos Pharm Sh.P.K. me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/8677 i datës 01.06.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Matkos Pharm” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 05.07.2021, ka iniciuar kontest tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/8677 të datës 01.06.2021, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, të anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/8677 i datës 01.06.2021 i Doganës së Kosovës si-Spektori për Kontrolla pas Importuese. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën

përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë kërkesë padisë duke konsideruar që e paditura me vendimin e atakuar ka rënë në kundërshtim me ligjin si dhe pa u bazuar në prova dhe fakte e ka detyruar paditësin të paguajë shumën prej 28,107.76 euro dhe ky detyrim është si pasojë e vendimit të atakuar. Më tej ka theksuar se provat e bashkangjitura në padi si dhe provat që do të dorëzoheshin në seancë do të vërtetojnë faktin se e paditura pa u bazuar saktë në gjendjen faktike ka nxjerrë një vendim të kundërligjshëm, andaj gjykatës i ka propozuar që në cilësinë e palës të dëgjohet paditësi i cili ndër të tjera do të tregoj faktin se në këtë detyrim nga e paditura pikërisht në kohën e pandemisë i është vështirësuar ushtrimi veprimtarisë duke rrezikuar edhe largimin e punëtorëve e krejt kjo si rezultat i një vendimi që e paditura ka detyruar paditësin të paguaj shumën si më lart në mënyre retroaktive- do të thotë kthimin pas tre viteve duke e ndryshuar kodin tarifor dhe mbi këtë bazë detyron këtë shumë paditësin që në emër të TVSH –së dhe Doganës e që realisht bie në kundërshtim me ligjet tjera në fuqi si ligji i TVSH-dë, sepse paditësi vlerën sa i përket TVSH-së do ta kishte bartur te kostoja e mallit- konsumatorët e fundit ashtu siç parashihet me ligjin e TVSH-së dhe në këtë mënyrë padrejtësisht duke llogaritur tre vitet paraprake të kaluar e detyron të paguaj paditësin. Tutje ka shtuar se paditësi duke u gjendur në një situatë të pavolitshme detyrohet që pa vullnetin e saj edhe pse ka konsideruar se kjo shumë dhe detyrim është e padrejtë ka lidh marrëveshje për të paguar shumën e caktuar për çka edhe është dëmtuar jashtëzakonisht shumë. Ka theksuar se Dogana e Kosovës sektori i tarifës për mendim tarifor e ndërron kodin tarifor padrejtë edhe pse paditësi sipas kodit të mëparshëm tarifor e ku i njëjti për produktin e importuar është licencuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale është cilësuar si produkt medicinal po me atë kod tarifor dhe i njëjti ka paguar të gjitha detyrimet siç parashihej nga Dogana e Kosovës. Gjykatës i ka dorëzuar provat shtesë dhe atë Licencën nga AKPM-ja A-0020/20 e cila i ka tri faqe, DUD-in doganor nr. R1046, dokumentin e transportit , fatura nr. 2020-306. Gjykatës i ka propozuar dëgjimin e palës si dhe nxjerrjen e provës me ekspertizë ku si detyrë e ekspertit do të jetë llogaritja e dëmit me kamatë ligjore 8% të shkaktuar si pasojë e vendimit të atakuar. Në fjalën përfundimtare ka shtuara se është vërtetuar fakti vendimtar se e paditura kundërligjshëm duke rënë ndesh me ligjin e TVSH-së në Republikën e Kosovës ka nxjerrë një vendim me të cilin ka vendosur në mënyrë retroaktive për paditësin dhe në këtë mënyrë e ka dëmtuar konsiderueshëm duke e rënduar edhe ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, si dhe duke krijuar pasiguri në tregun e Kosovës sepse edhe e paditura edhe pse thirret në Kodin Doganor që ka të drejtë të kthehet në mënyrë retroaktive për tri vite bie në kundërshtim me Ligjin për TVSH-në ku ligji parasheh që tatimi mbi vlerën e shtuar në fund bartet nga konsumatori i fundit, ku në këtë mënyrë e paditura ia ka pamundësuar paditësit që tatimi mbi vlerën e shtuar ti bartet

konsumatorit të fundit, respektivisht teknikëve dentar dhe stomatologëve sepse produkti është specifikisht mjekësor dhe atë e përdorin vetëm teknikët dentar dhe stomatologët, që janë konsumatorët e fundit. Së fundi ka kërkuar që sipas nenit 17 të LKA-së të kompensohet paditësi ashtu që e paditura të paguajë dëmin e shkaktuar në vlerë prej 28,107.76 euro me kamatë ligjor e prej 8%, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës për përpilimin e padisë në vlerë prej 156 euro për përfaqësimin në tri seanca në vlerë prej 810 secila nga 270 euro dhe taksën e gjykatës në vlerë prej 50 euro, të gjitha këto sipas OAK-së dhe Udhëzimit për Taksa Gjyqësore.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 05.10.2021 e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës ka shtuar se aktvendimi kontestues me nr.8677/2021 është i ligjshëm dhe i drejtë pasi që i njëjti bazohet tërësisht në Kodin Doganor dhe procedurat e importit të cilat e paditura i aplikon për të gjitha subjektet gjatë procedurës së importit. Me tej ka shtuar se e paditura i ka sqaruar subjektit në procedurën e ankesës se aktvendimi i kontrollës pas importit është marrë konform dispozitave ligjore të KDA-së më saktësisht nenit 81 par 1,2,3, pasi që i njëjti është bazuar në mendimin tarifor të një sektori profesional i cili ekskluzivisht merret me tarifa dhe është i vetmi i cili mund të jep mendim tarifor. Po ashtu ka shtuar se pretendimet e subjektit se Dogana ka shkelur ligjin kur ka ndërruar numrin tarifor nuk ekziston sepse këto sqarime i janë dhënë subjektit në arsyetimin e mendimit tarifor nr.31/21. I ka kundërshtuar edhe pretendimet e subjektit duke sqaruar se AKPM-ja nuk është subjekt i cili mund të jep klasifikim të numrit tarifor, por jep licencë të produkteve medicinale, ndërsa lidhur me propozimin e paditësit për dëgjimin e palës ka theksuar se konsideron se u thanë të gjitha, por i mbetet gjykatës të vendos lidhur me këtë propozim. Gjithashtu edhe me provat e dorëzuara në këtë seancë nga paditësi, kanë qenë prova të bashkangjitura gjatë procedurës të zhdoganimit të mallit, andaj konsideron se nuk mund të vërtetojnë ndonjë gjë. Po ashtu ka shtuar se edhe vendimi nga Sektori i kontrollës pas importit është një vendim që është bazuar në nenin 82 të KDA-së, andaj i ka kërkuar gjykatës që të merr aktgjykim që të lë në fuqi vendimin kontestues si të drejtë dhe të ligjshëm, dhe të hedh në tërësi kërkesëpadinë dhe padinë e paditësit.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurë provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 12.02.2024, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi nr. 01.3.2.2/8677 i datës 01.06.2021, Aktvendim nr. 03.1.1-2021-16 i datës 21.04.2021, Kapitujt e Tarifës së Integruar të Kosovës, Kapitulli 30 i TARIK-ut, Qarkullimi i

llogarisë së biznesit i datës 01.07.2021, Sqarimi i dorëzuar në seancën e datës 13.02.2024 përpiluar nga pronari i biznesit Kastriot Vitija, Aktgjykim A.nr. 1955/21, Sqarim i dorëzuar në seancën e datës 06.02.2024, DUD-i R 3213 i datës 12.03.2018, Faturë nr. 1801110 e datës 03.06.2018, Komunikim elektronik me zyrtarët e doganës, Licencën lëshuar nga AKPPM me nr. A-0020/20, DUD R 1046 i datës 24.01.2020 bashkë me fatura përcjellëse, Përgjigje në padi e datës 25.02.2022, Mendim për klasifikim tarifor nr.31 i datës 17.03.2021, Ankesë e datës 19.05.2021, Urdhërpagesë e datës 21.04.2021, Kërkesë për tarifim të mallit e datës 12.03.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar-administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, shkresat e lëndës, aktvendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi ka paraqitur DUD-at: R26029 i datës 17.05.2018; 42736 i datës 25.07.2018; 3170 i datës 25.01.2019; 19767 i datës 17.04.2019; 41962 i datës 13.07.2019; 64252 i datës 12.10.2019; 80381 i datës 18.12.2019; 833 18 i datës 30.12.2019; 15585 i datës 23.03.2020 të proceduar ne ZBD Prishtinë; 12327 i datës 10.09.2018; 5437 i datës 27.04.2019; 1046 i datës 24,01.2020; 7018 i datës 03.07.2020; 10924 i datës 24.09.2020; 14536 i datës 27.11.2020; 16147 i datës 25.12.2020 te proceduar ne Z.D. Aeroporti i Prishtinës dhe 28926 i datës 07.12.2018 i proceduar ne ZBD Interevropa për zhdoganim me regjim IM4, në këtë rast janë proceduar dhe janë pranuar si të tillë. Sektori i Kontrollës pas Importuese duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të kërkesës me nr. SHB-II-002-130121 të datës 13.01.2021, me datë 21.04.2021 ka nxjerr Aktvendimin nr.03.1.1-2021-16 me të cilin ka ndryshuar numrat tarifor dhe si rrjedhojë ka obliguar paditësin me detyrime shtesë në emër të taksës doganore dhe taksës për TVSH. Po ashtu jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi ka ushtruar ankesë pran Doganës së Kosovës e për të cilën ankesë Dogana e Kosovës me datë 01.06.2021 me Aktvendim nr. 01.3.2.2/8677 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë, kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 05.07.2021 ka iniciuar konflikt administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në procedurën e rishqyrtimit të aktvendimit 03.01.1-2018-448/1 të datës 25.07.2018 e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit si të pabazuar me arsyetim se Dogana e Kosovës ka ardhur në përfundim se paditësi me rastin e zhdoganimit të mallit kontestues nuk ka vepruar drejtë pasi që malli ishte dashur të klasifikohet me numrin tarifor 3824999600 dhe si rezultat ishte dashur ti nënshtrohet pagesës së taksave doganore dhe TVSH-së. Vendimin për ndryshimin e kodit tarifor e paditura e ka marr duke u bazuar në Mendimin mbi klasifikimin tarifor të sektorit të tarifës 04.1.1 nr.31/17.03.2021.

Gjykata me propozim të palës paditëse gjatë seancës ka dëgjuar dëshmitarin Fatmir Maloku, në cilësi të udhëheqësit të Sektorit të Tarifave në Doganën e Kosovës. Nga deklarata e dëshmitarit, Gjykata ka konstatuar se mendimi i sektorit të tarifave është bazuar në opinionin e Organizatës Botërore të Doganave nr.3824 99/23, i cili opinion produktin e kontestuar “bllokat e zirkonit” i ka klasifikuar me kreun tarifor 382499. Sipas deklaratave të të njëjtit ky opinion është nxjerr në vitin 2019, mirëpo sektori i tarifave për të njëjtin ka mësuar në vitin 2021 dhe se me të njëjtin janë të informuara zyrat regjionale.

Nga aktvendimi i kontestuar gjykata vëren se ai përmban të meta të tilla, për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Vendimi i kontestuar është juridikisht i pa qartë, i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin e tij. Arsyetimi i vendimit është jo i plotë me të dhëna të pamjaftueshme lidhur me ndryshimin e kodit tarifor për mallin lëndor.

Arsyetimi i vendimit kontestues dhe deklaratat e dëshmitarit, pasqyrojnë gjendje të ndryshme të konkludimit, ku sipas vendimit kontestues i cili ishte i bazuar në mendimin tarifor rrjedh se kodi tarifor është ndryshuar pas marrjes së përgjigjes nga AKPM, e cila sugjeron që me rastin e importit të aplikohet L04 dhe marr parasysh se këto produktet edhe në raste tjera janë futur me licencë për import të pajisjeve medicinale, e bazuar edhe në sqarimet e marra nga shtetit i Çekisë ku duhet të futen me licencë importi, ndërsa kodi tarifor 6909 19 nuk e kërkon këtë, andaj është vendosur që kodi i përshtatshëm është 3824 9996 00. Megjithatë, nga deklarata e dëshmitarit në cilësi të udhëheqësit të Sektorit tarifor rezulton se ndryshimi i kodit doganor është bazuar në opinionin e OBD-së të cilin Sektori Tarifor e kanë pranuar me 2021.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritorë në këtë konflikt tregtar administrativ, për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë

vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe se arsyetimi i të paditurës për gjykatën është i pa bazuar dhe nuk mbështetet në asnjë dëshmi konkrete mbi ndryshimin e kodit tarifor. Gjykata thekson se e paditura duhet të sqaroj aplikimin retroaktiv të vendimit për të cilin nuk ka pasur njohuri në kohën kur mallrat janë pranuar me kodin tarifor të deklaruar.

Kontrollimi i deklaratave pas zhdoganimit, është i rregulluar me nenin 82 të KDAK-së, i cili në paragrafin 3 përcakton *”Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmerr masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion.”*

Gjykata vlerëson se e paditur dispozitën e lartcekur nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm. Informatat e reja që janë në dispozicion nuk konsistojnë në informatat rreth aplikimit të detyrimeve shtesë të cilat as vet e paditura nuk i ka poseduar, por informatat e reja konsistojnë në ndonjë informacion që e paditura mund të ketë marr në rast se paditësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Sipas nenit 123 të UA 11/2009 për zbatimin e Kodit Doganor dhe Akcizave decidivisht përcaktohen dokumentet që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të mallrave: *“1. Dokumentet ne vijim duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë: a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti; b) Kur kërkohet sipas Nenit 88 të këtij akti, deklarata për vlerat doganore të mallrave të deklaruarat i bëjnë në përputhje me kushtet e paraqitura në nenin e dhënë; c) Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruarat; d) Të gjitha dokumentet e tjera të kërkuara për aplikimin e dispozitave që rregullojnë lirinë për qarkullim të lirë të mallrave të deklaruarat.”*. Konform kësaj dispozite gjykata konkludon se paditësi gjatë procedurës së zhdoganimit ka paraqitur faturën nga eksportuesi i mallit të shtetit eksportues e cila përputhet me kodin tarifor të deklaruar.

Rrjedhimisht, gjykata e obligon të paditurën që në rishqyrtim dhe rivendosje, të deklarohet lidhur me vendimin për aplikimin retroaktiv të opinionit të lartcekur. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga

dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitën ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave, duke pasur parasysh edhe praktiken doganore në rastet e ngjashme. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Për arsyet e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.335/22, datë 28.02.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.